

center for
transparency
and free
information



Ambasada Britanike
Tiranë

Cfarë thonë gjykatësit

Reforma në drejtësi, aksesit në gjykata,
korrupsioni në gjyqësor

Anketimi II me gjykatësit e shkallës së parë

Tiranë, 2014

Përmbajtja:

Metodologjia f.3

Aksesi në gjykata: 4

Reforma në gjyqësor: 8

Promovimi i gjyqtarëve: 11

Pyetje rreth gjyqësorit dhe perceptimi i gjykatësve për institucionet e tjera: 12

Kushtet e punës: 15

Propozime të gjyqtarëve: 24

Përfundime: 26

Rekomandime: 28

Metodologjia:

Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë (QTIL)*¹ në kuadër të projektit të mbështetur “Rritja e aksesit në drejtësi dhe përmirësimi i procedurave në gjykatë” ka realizuar edhe një anketim me gjykatësit e shkallës së parë të gjyqësorit. Përgaditja e sondazhit nisi që në tetor të vitit 2013, ndërsa anketimi u krye përgjatë muajve prill-qershor 2014. U përfshinë në anketim 34% e gjykatave të shkallës së parë në të gjithë vendin ndërsa gjyqtarët që u përgjigjën në anketim zënë afërisht 25% të të gjithë numrit të gjykatësve të shkallës së parë në vend. Projekti është mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Përzgjedhja përfshin gjykata të vendosura në qytete të kategorisë së parë ose gjykata të karrierës sic është ajo e Tiranës dhe Durrësit, gjykata të vendosura në qytete të tjera të mëdha të vendit si në Fier, Vlorë, Elbasan por edhe gjykata në qytete më të vogla si në Sarandë apo Pogradec.

Objektivi i anketimit ishte:

- a. zbardhja e problematikave që lidhen me aksesin e qytetarëve në gjykata
- b. këndvështrimi i gjyqtarëve për reformat e nisura në drejtësi si dhe për institucionet që drejtojnë apo kanë lidhje me gjyqësorin,
- c. matja e perceptimit të gjyqësorit për vetë gjyqësorin dhe
- d. matja e perceptimit të gjyqësorit për pushtetet dhe institucionet e tjera.

Qëllimi i anketimit ishte:

- a. krijimi i hapësirave më të mëdha për një akses të barabartë në gjykata përmes përmirësimit të procedurave atje.
- b. marrja e mendimit të gjykatësve për reformat si një actor kryesor i sistemit të drejtësisë,
- c. pjesëmarrja e gjyqtarëve në debatin publik për reformën e sistemit gjyqësor dhe institucioneve të tjera.

Teknikat:

- pyetësi u hartua në konsultim të specialistëve të komunikimit dhe ekspertëve të drejtësisë dhe gjyqësorit
- sondazhi u plotësoa nga vetë gjyqtari në mënyrë manuale, anketuesi ka ndërhyrë vetëm me kërkesën e gjyqtarit gjatë plotësimit të formularit për sqarime të nevojshme rreth pyetjeve
- gjyqtarët mund ta identifikonin veten në sondazh vetëm nëse dëshironin por edhe këtë identifikim vetëm nëpërmjet numrit të telefonit.
- gjyqtarët që kanë dashur kanë pasur mundësi të ruajnë një kopje të formularit të plotësuar

¹ QTIL është organizatë e shoqërisë civile me zyrë në Tiranë, themeluar në vitin 2003, e specializuar në çështjet e monitorimit, transparencës dhe qeverisjes së mirë. QTIL shërben si reporter lokal për Global Integrity, organizatë ndërkombëtare me qendër në Uashington DC, SHBA dhe është anëtare e rrjetit ndërkombëtar të PËYP (Publish Èhat You Pay), me qendër në Londër, Britani.


-po ashtu gjyqtarët kanë patur mundësi të bëjnë komente rreth përgjigjes së tyre
-pyetësi përfshin gjithsej 38 pyetje prej të cilave 8 pyetje me disa mundësi zgjedhjeje, 30 pyetje me një mundësi zgjedhjeje ndër to 4 pyetje me mundësi shtjellimi me tekst nga ana e vet të anketuarit.

Theksohet se në të dhënat e mëposhtme janë trajtuar vetëm përgjigjet. Nuk janë matur ata që nuk kanë dhënë përgjigje për pyetje të caktuara. Kjo ndonjëherë shpjegon edhe disa diferenca që shfaqen kur krahasohen të dhëna të sondazhit të vitit 2012 me ato të këtij viti për të njëjtat pyetje. Në atë vit u matën edhe abstenimi it ë anketuarve.

Përpunimi i të dhënave është bërë nëpërmjet programit EXEL pasi ato janë hedhur më parë në një soft të përgaditur në përputhje me pyetjet e projektuara dhe shpjegimet me shkrim.


Përzgjedhja:

Rreth 46 për qind e gjykatësve të anketuar gjykojnë çështje penale, ndërsa 51 për qind gjykojnë çështje civile. Rreth 3 për qind të të anketuarve i përkasin gjykatave administrative.




Aksesi në gjykata:


Gjyqtarët kanë përzgjedhur si shkaqe që pengojnë aksesin e qytetarëve në gjykata shtyrjen e seancave gjyqësore në masën 30 për qind, dhe në pot ë njëtën masë mungesëne sallave të gjyqit. Disa gjykatës thonë se aksesin zvogëlohte edhe për shkak të numrit të vogël të gjykatësve. Më pak është numri i atyre që kanë zgjedhur si shkak të aksesit të dobët në gjykata procedurat birokratuike atje dhe shtyrjen shpalljes së vendimeve. Në fund, vetëm më 2.2 për qind vjen tarifat gjyqësore duke shënuar kështu edhe efektin e ndryshimit të vendimit të vitit 2010 që u bë në nëntor të vitit 2013, ndryhsim i cili u inicua nga QTIL në pranverën dhe verën e vitit të kaluar.




Gjyqtarët kishin mundësi të zgjedhin mes katër arsyeve për dështimin e proceseve gjyqësore. Ata kanë përcaktuar në masën 61 për qind mungesat në ligj, 17 për qind ndërhyrjet në procesin gjyqësor, 12 për qind mungesa në profesionalizmin e gjyqtarëve dhe 10 për qind mungesa në profesionalizmin e prokurorëve.




Shtyrja e proceseve gjyqësore ka ndodhur në masën 23 për qind për shkak të mungesës së palëve, në 20 për qind për shkak të mungesës së dëshmitarëve, në 24 për qind për mungesë të avokatit dhe më pak të ekspertëve dhe prokurorit.




Sipas gjyqtarëve të përfshirë në anketim, dëshmitarët, pala apo palët nuk kanë ardhur në gjykim sepse nuk janë lajmëruar në 31 për qind të rasteve, janë lajmëruar por nuk kanë ardhur në 51 për qind të rasteve.




Gjyqtarët sugjerojnë se dëshmitarët dhe palët në process duhen thirrur duke përdorur dy shërbimet, ftuesit dhe postën nëq masën 71 për qind, kanë zgjedhur vetëm shërbimin e postës, 21 për aind etyre ndërsa vetëm ftuesit e gjykatës janë përzgjedhur nga vetëm 6 për iand e gjykatësve.



Po ashtu gjyqtarët kanë dhënë gjykimin e tyre rreth shpërblimit për ekspertet dhe dëshmitarët duke theksuar se në 22 për qind të rasteve ato jepen me vonesë, në 16 për qind ato jepen në kohë, në 9 për aind të rasteve janë shprehur se ka shumë procedura dhe 2 për aind e gjykatësve mendojnë se procedurat janë të thjeshta. Pjesa tjetër e gjyqtarëve janë shprehur rreth masës së shpërblimit.






Mungesat e dëshmitarëve në seanca gjyqësore sipas gjyqtarëve kanë ndodhur në masën 30 për qind pasi ata nuk janë lajmëruar ose nuk janë lajmëruar në kohë, në 18 për qind të rasteve dëshmitarët janë ankuar se kanë dieta të pamjaftueshme, 10 për qind për shkak se nuk kanë siguri. Por 42 për qind e dëshmitarëve nuk kanë shprehur ndonjë ankesë.





Reforma në gjyqësor:

Gjyqtarët janë pyetur lidhur me reformën në gjyqësor dhe që në fillim janë përcaktuar rreth problemti më të madh të gjyqësorit të seleksionuar mes gjahstë të tillë. Rreth 29 për qind e zgjedhjeve shënojnë ndërhyrjen nga politika si problemi më i madh i gjyqësorit, 26 për qind e zgjedhjeve shënojnë mungesën e kuadrit ligjor, 14 për qind korrupsionin në drejtësi, 11 për qind mungesën e profesionalizmit dhe ndërhyrjen nga qeveria, ndërsa drejtuesit e gjyqësorit janë seleksionuar si problem vetëm në 9 për qind të rasteve.





Duke u shprehur për nevojën e reformimit të institucioneve që lidhen me drejtësinë ata janë vënë përpara zgjedhjes mes Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së, konferencës gjyqësore , prokurorisë dhe gjykatave. Gjyqtarët kanë përzgjedhur në masën 36 për qind nevojën e reformit të KLD, në 23 për qind nevojën për reformim të ministrisë së Drejtësisë, në 15 për qind reformën në prokurori dhe në 13 për ian reformnë në gjykata dhe konferencën gjyqësore.




Gjyqtarët janë shprehur edhe rreth çështjes së cili institucion duhet të drejtojë apo të kryejë kryesisht reformën në drejtësi. Ata kanë përzgjedhur për këtë mission më së

shumti KLD në masën 28 për qind, për të vijuar me ekspertët e huaj në masën 24 për qind. Gjyqtarët kanë vendosur në vendin e tretë mes pesë mundësive, ministrinë e Drejtësisë me 19 për qind duke përfunduar me qeverinë dhe shoqërinë civile në të njëjtën masë prej 15 për qind.




Sipas gjyqtarëve reforma duhet të synojë më së shumti përmirësimin e kuadrit kligjor në masën 36 për qind, institucionet e kontrollit të gjyqësorit dhe përmirësimin e procedurave në gjykata në masën 23 për qind dhe në fund kanë kërkyar reformë në procedurat e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve në masën 18 për qind.




Promovimi i gjyqtarëve:


Gjyqtarët kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me praktikën e promovimit të gjyqtarëve duke shënuar përmirësimin e tyre në krahasim me ato të mëparshmet. Promovimi i gjyqtarëve përpara përdorimit të sistemit të pikëzimit është konsideruar prje tyre si i padrjetë në masën 67 për qind dhe i drejtë vetëm me 6 për qind.



Ndërsa sistemi i ri sërish ka vlerësim të qortueshëm. 49 për qind kanë zgjedhur se ai është sërish i padrejtë, por gjithsesi në rend zbritës prej më shumë se 15 për qind krahasuar me atë të mëparshmin. 26 për qind mendojnë se ai është konkurent ose dyfish në krahasim me sistemin e vjetër.




Në grafikun e mëposhtëm shikohet më qartë diferenca në vlerësim për të dy modelet e promovimit të gjyqtarëve, atë që shtë përdorur nga viti 2000 deri në vitin 2012 dhe atë që është përdorur vitin e fundit.




Pyetje rreth gjyqësorit dhe perceptimi i gjykatësve për institucionet e tjera:


Numri më i madh i gjyqtarëve hedhin poshtë perceptimin e të tjerëve për gjyqësorin si i korruptuar duke vlerësuar në masën 63 për qind se korrupsioni në drejtësi është vetëm perceptim. Por ndërkaj 35 për qind e të anketuarve thonë se ka korrupsion në drejtësi dhe vetëm 3 për qind e të pyeturve janë kategorikë rreth tij duke theksuar se nuk ka fare korrupsion.




Rreth raportit që gjyqësori ka me politikën, rreth 69 për qind kanë vlerësuar se ai është i varur pjesërisht nga politika, 22 për qind thonë se është i pavarur prej saj ndërsa vetëm 9 për qind janë të bindur se gjyqësori ka varësi politike.




Gjyqtarët në 72 për qind të rasteve thonë se nuk kanë pasur ndonjë ofertë pagese në këmbim të favorizimit në një process gjyqësor ndërsa 28 për qind thonë se kanë pasur oferta të tilla.




Lidhur me ndërhyrjet në proceset gjyqësore, gjyqtarët kanë seleksionuar në 37 për qind të rasteve ndërhyrjet që vijnë nga individë pa ndonjë kontekst politik apo institucional, në 27 për qind ndërhyrja vjen nga avokatët, në 12 për qind ndërhyrja ka ardhur nga zyrtarë të qeverisë dhe parlamentit dhe nga 10 për qind prej zyrtarëve të pushtetit lokal. Ndërhyrja nga Presidenca ka ndodhur vetëm në 1.3 për qind të rasteve.






Ne 2012:

Krahasuar më 2 vjet më parë ka një rritje të theksuar nga ndërhyrjet prej qeverisë dhe parlamentit dhe një ulje të ndërhyrjeve nga presidenca. Ndërhyrjet nga individë dhe avokatë ruajnë të dhëna të përafërta.




Kushtet e punës:

Gjyqtarët vijojnë të mos jenë të kënaqur me pagën në masën 72 për qind dhe paksa në masën 22 për qind. Vetëm 6 për qind e tyre mendojnë se kanë një pagë të mjaftueshme.




2012:

Krahasuar me sondazhin e zhvilluar në vitin 2012, për të njëjtën pyetje ka pothuajse një përgjigje të përafërt.




Lidhur me sigurinë në punë, sërish numri i gjykatësve që mendojnë se nuk ka siguri është i madh. Rreth 49 për qind nuk ndihen të sigurtë përkundrejt 19 për qind që janë të sigurtë.




2012:

Krahasuar me vitin 2012 ka rritje të numrit të gjyqtarëve që nuk kanë siguri në punë, ndërsa shifrat e tjera qëndrojnë në të njëjtat nivele.




Për gjyqtarët KLD ka punuar mjaftueshëm në masën 46 për qind, mirë në masën 31 për qind dhe keq në masën 23 për qind.




2012:


Krahasuar me vitin 2012 nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor të shifrave përveç faktit se ka një rritje të vlerësimit keq.




Pothuajse të njëjtat vlerësime ruhen edhe për ministrinë e Drejtësisë por duke marrë më shumë vlerësime mjaftueshëm dhe keq krahasuar me KLD.




2012: E njëjta pamje paraqitet përafërsisht edhe për vitin 2012 lidhur me vlerësimin mjaftueshëm por ka një rritje për vlerësimin keq.



Për Konferencën Gjyqësore të anketuarit janë shprehur me nota më positive se dy institucionet e tjera. Ata thonë se ka punuar mirë ose mjaftueshëm sipas 83 për qind të zgjedhjeve që kanë bërë të anketuarit.




Gjyqtarët përvec se akuzohen për korrupsion janë të detyruar të vuajnë edhe korrupsionin në sektorët e tjerë. Për të matur këtë fenomen janë zgjedhur dy sektorë me risk të lartë korrupsioni dhe ryshfeti si mjekësia dhe administrata e institucioneve publike. Gjyqtarët kanë paguar për shërbime mjekësore që merren falas në 18 për qind të rasteve.




Ndërsa në institucione të tjera publike kanë paguar rregullisht vetëm 3 për qind e tyre. Ndonjëherë kanë paguar 12 për qind e gjykatësve, por në shumicën dërmuese, 85 për qind e tyre nuk kanë paguar asnjëherë.

A keni paguar kur keni marrë një shërbim nga administrata publike që jepet pa pagesë:




Sërish gjyqtarët edhe në vitin 2014 ashtu si në vitin 2012 mendojnë në shumicë se shoqëria civile nuk e ka ndihmuar gjyqësorin.

Mendoni se shoqëria civile:




2012:

Shifrat e gjetura në sondazhin e 2012 nuk ndryshojnë shumë me ato të gjetura në vitin 2014




Por ka ndryshuar fort qëndrimi i gjykatësve në raport me median dy vitet e fundit. Për të anketuarit, median përbën presion për ta në masën 62 për qind dhe mbështetje vetëm 9 për qind.




2012:


Para dy vitesh media përbente presion në masën 32 për qind dhe mbështetje në masën 13 për qind. Ndryshimi radikal gjatë këtyre dy viteve mund të jetë i lidhur me retorikën e muajve të fundit lidhur me reformat në drejtësi që shoqërohen edhe me akuza për gjyqesorin



Gjykatësit kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me korrupsionin për institucionet publike të vendit përfshirë edhe median. Sipas tyre qeveria dhe media janë dy institucionet më të korrupuara, në të njëjtën masë për 35 për qind të të anketuarve, duke vijuar më pas me Parlamentin me 19 për qind. Presidenti dhe prokuroria vijnë në fund respektivisht me 6 për qind dhe 5 për qind.



Ndërs anë pyetjen e anasjelltë se kush institucion është më i pakorrupuari, vijohet më Presidencën në masë 60 për qind për të vazhduar më median, parlamentin, qeverinë, prokurorinë.



Propozime te gjyqtarëve:

Në vijim janë zbardhur të gjitha përgjigjet në pyetjen e lirë për të anketuarit: Nëse do të kishit mundësi të ndryshonit diçka në sistemin e drejtësisë, çfarë do të bënit që në fillim? (numrat rendor janë kodet e anketimeve)

2-Do të mundësoja gjetjen e mekanizmave për të ulur ngarkesën e gjyqtarëve, me qëllim rritjen e profesionalizmit në arsyetimin e vendimeve dhe caktimin e seancave gjyqësore më afër në kohë. P. sh, profesionalizëm të sekretarëve gjyqësorë, ndihmës ligjorë për qytetarët ose zgjatje të afatit për zbardhjen e vendimeve gjyqësore.

4-Do të ndryshoja kuadrin ligjor të vlerësimit të gjyqtarëve dhe sistemit të karrierës së tyre, në funksion të promovimit.

5- Ti jepja më shumë kohë gjyqtarëve për të arsyetuar vendimet.

9- Do të reformoja institucionin e KLD-së, me përbërje, profesionalistë të pavarur dhe me integritet. Për anëtarët që zgjidhen nga Konferenca, duhet të jepet mendimi “i imponuar” (e drejta e shkëmbimit dhe e të zgjedhurve nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare).

10-Drejtuesit e gjykatave të kishin vetëm kompetenca adminsitatori me afat 3-vjeçar dhe të mos gjykonin. Gjyqtari të mos merrej me anët administrative të procesit duke garantuar një personel profesionist që dinë të formulojnë urdhërimet e gjyqtarit. Duke u marrë gjyqtari vetëm me gjykimin dhe metodologjinë e tij rast pas rasti. Dhe jo duke plotësuar sekretarin, pra duke bërë punët administrative të tij, pasi nuk dinë të zbardhin asnjë detyrë të urdhëruar.

11-Procedurat e emërimit të gjyqtarëve dhe sistemin e vlerësimit, përcaktimin e kritereve për promovimin, reformimi I rekrutimit të gjyqtarëve në shkallët më të larta të gjyqësorit dhe në KLD.

14-Miratimi i statusit të i gjyqtarit.

17- Promovim material i gjyqtarëve, rritja e pagave i ndjekur nga një kontroll i rreptë.

Shtimi i numrit të gjyqtarëve.

18-Do të kërkoja që të rritej faktori ndihmës, për shembull përmirësimi i infrastrukturës së gjykatave; shërbimi postar (sistemi adresave); rritja e numrit të ftuesve gjyqësorë dhe

administratës; rritja e rolit të kryetarit të gjykatës; të rritet buxheti i gjykatave duke përcaktuar një përqindje 5 – 7 % e buxhetit të shtetit; do të kontribuojë në përmirësimin e dispozitave procedurale (civile dhe penale) në mënyrë që të rritet shpejtësia e gjykimit; vendosje e gjobave për mungesë dhe mosparaqitje në seancë; rishikimi i ligjit “Për Avokatinë”; të rriten tarifat e pagesave për avokatët e caktuar kryesisht.

19-Do zgjidhja për drejtyues gjykatash dhe KLD njerëz me përvojë dhe të kishin personalitet, të papërfolur nga shoqëria për afëra korruptive, të kenë dhënë prova ndershmerie (pa lidhje me politikën).

20-Rritja e pavarësisë. Unifikim i praktikës gjyqësore.

26- Rritjen e menjëhershme të pagave të gjyqtarëve, përmirësimin e sigurisë dhe kushteve të punës, konsolidimin e sistemit të llogaridhënies dhe kontrollit, forcimin e sistemit të konkurrencës.

28-përmirësimin e trajtimit financiar i gjyqtarëve.

29- Do të rivlerësoja të gjithë kuadrin ligjor, për të parë se ku duhet ndryshuar.

31-Do të kërkoja ndryshimin e Ligjit të “Kodit të Procedurës Penale”, në lidhje me zbatimin sa më thjeshtë të këtij ligji.

35-Heqjen e kompetencës së Ministrit të Drejtësisë, për të nisur procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve.

37-Përmirësim i legjislacionit, unifikim i praktikës gjyqësore, rishikim i kompetencave të Gjykatës së Lartë.

38-Përmirësim i kuadrin ligjor.

39-Gjyqtarët të emërohen jo direkt nga shkolla por pas një stazhi 10 vjet punë si avokatë, në administratën civile e institucione të tjera. Paga të jetë sa paga e një avokati mesatar.

41-Ndryshimi duhet të fillojë nga lartë poshtë, nga Gjykata e Lartë, Apel, pastaj Shkalla e Parë. Efekt kanë vendimet e formës së prerë. Një gjykatë Apeli e fortë, shmang vendimet e padrejta dhe të pavarura.

42-Rritjen e pagave për gjyqtarët, sigurimin e kushteve për banim dhe udhëtimin në rastin kur punojnë jashtë vendbanimit, rritjen e sigurisë për gjyqtarët.

43-Rritja e transparencës në gjykimet civile, penale dhe administrative, si edhe krijimi i një qendre të studimeve të praktikës gjyqësore.

44- Rishikimi i procedurave të gjyqësorit, duke i plotësuar, saktësuar dhe duke parashikuar mjete ligjore në ndihmë të gjykatës dhe infrastrukturës së shërbimit të saj, në proceset e gjykimit. Trajtimi i gjyqtarëve me paga më të mira dhe shpërblim sipas ngarkesës në punë, nevojë për standarde.

47-Do të vendosja statusin e gjyqtarit, përmirësimi i kushteve financiare, eliminimi i inspektorateve të Ministrisë së Drejtësisë të “Kryetarit”, të “Kancelarit”, që veprojnë faktikisht si “inspektorë”. Liberalizimi i përzgjedhjes së gjyqtarëve në KLD. Meritokracia në karrierë dhe reformimi i Shkollës së Magjistraturës, që të nxjerrë gjyqtarë profesionistë.

50-Do të forcoja statusin e inspektorëve dhe profesionalizmin e tyre.

51-Reformimi i KLD-së. Zgjedhjen sipas meritës të gjyqtarëve në gjykatat më të larta.

52-Përmirësimin e kuadrin ligjor, procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të gjyqtarëve, shmangien e procedurave burokratike në veprimtarinë e gjykatave, etj.

53-Mënyrën e emërimit të gjyqtarëve të të gjitha shkallëve.

55-Ndryshimin e sistemit, ose të paktën e disa procedurave ligjore.

59-Domosdoshmërisht, përveç trajnimit të vazhdueshëm profesional dhe rritjen e nivelit të pagave, gjë e cila ka impakt pozitiv.

61- Për mendimin tim, më i korruptuar është politika e cila me ndërhyrjet e saja, emërimet nepotike dhe korruptive në gjyqësor, ka dëmtuar rëndë imazhin e gjyqësorit.

62-Mospjesëmarrja e Ministrit në KLD dhe shkrirja e Inspektoratit të kontrollit të gjyqësorit nga Ministria e Drejtësisë.

63-Do të shkëpusja kontrollin e gjykatave nga Ministria e Drejtësisë dhe inicimin e saj për procedim disiplinor, pasi ai bëhet selektiv dhe i paragjykuar.

65-Ndryshimin kushtetues të kompozimit të KLD-së. Anëtarët duhet të jenë me kohë të plotë. Kryetari dhe nënkryetari duhet të jenë gjyqtarë. Përcaktimin kushtetues të përqindjes së buxhetit të gjykatave në raport me Buxhetin e Shtetit. Ndryshimin e ligjeve për Gjykatën e Lartë, KLD-në, për gjykatat e ulëta, etj.

66-Heqja e të drejtës ekskluzive për Ministrin e Drejtësisë në propozimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Rritja e numrit të inspektorëve të KLD-së dhe performancës nga ana e tyre, shkrirja e inspektoratit të ministrisë.

Përfundime:

Aksesi në gjykata:

-Gjyqtarët kanë përzgjedhur si shkaqe që pengojnë aksesin e qytetarëve në gjykata shtyrjen e seancave gjyqësore në masën 30 për qind, dhe në po të njëjtën masë mungesën e sallave të gjyqit. Disa gjykatës thonë se aksesin zvogëlohet edhe për shkak të numrit të vogël të gjykatësve. Në fund, vetëm më 2.2 për qind vjen tarifat gjyqësore duke shënuar kështu edhe efektin e ndryshimit të vendimit të vitit 2010 që u bë në nëntor të vitit 2013, ndryshim i cili u inicua dhe u trajtua nga QTIL në pranverën dhe verën e vitit të kaluar.

-Sipas gjyqtarëve arsytet për dështimin e proceseve gjyqësore kanë të bëjnë në masën 61 për qind mungesat në ligj, 17 për qind ndërhyrjet në procesin gjyqësor, 12 për qind mungesa në profesionalizmin e gjyqtarëve dhe 10 për qind mungesa në profesionalizmin e prokurorëve.

-Vijon shtyrja e proceseve gjyqësore për shkak të mungesës së palëve në masën 23 për qind, për shkak të mungesës së dëshmitarëve në 20 për qind, për mungesë të avokatit në 24 për qind.

-Dëshmitarët, pala apo palët nuk kanë ardhur në gjykim sepse nuk janë lajmëruar në 31 për qind të rasteve, janë lajmëruar por nuk kanë ardhur në 51 për qind të rasteve.

-Gjyqtarët sugjerojnë se dëshmitarët dhe palët në process duhen thirrur duke përdorur dy shërbimet, ftuesit dhe postën në masën 71 për qind, kanë zgjedhur vetëm shërbimin e postës, 21 për qind e tyre ndërsa vetëm ftuesit e gjykatës janë përzgjedhur nga vetëm 6 për qind e gjykatësve.

Reforma në gjyqësor:

-Rreth 29 për qind e zgjedhjeve shënojnë ndërhyrjen nga politika si problemi më i madh i gjyqësorit, 26 për qind e zgjedhjeve shënojnë mungesën e kuadrit ligjor, 14 për qind korrupsionin në drejtësi, 11 për qind mungesën e profesionalizmit dhe ndërhyrjen nga qeveria, ndërsa drejtuesit e gjyqësorit janë seleksionuar si problem vetëm në 9 për qind të rasteve.

-Gjyqtarët kanë përzgjedhur në masën 36 për qind nevojën e reformimit të KLD, në 23 për qind nevojën për reformim të ministrisë së Drejtësisë, në 15 për qind reformën në Prokurori dhe në 13 për qind reformën në gjykata dhe konferencën gjyqësore.

-Gjyqtarët janë shprehur edhe rreth çështjes së cili institucion duhet të drejtojë apo të kryejë kryesisht reformën në drejtësi. Ata kanë përzgjedhur për këtë mision më së shumti KLD në masën 28 për qind, për të vijuar me ekspertët e huaj në masën 24 për qind. Gjyqtarët kanë vendosur në vendin e tretë mes pesë mundësive, ministrinë e Drejtësisë me 19 për qind duke përfunduar me qeverinë dhe shoqërinë civile në të njëjtën masë prej 15 për qind.

-Sipas gjyqtarëve reforma duhet të synojë më së shumti përmirësimin e kuadrit ligjor në masën 36 për qind, institucionet e kontrollit të gjyqësorit dhe përmirësimin e procedurave në gjykata në masën 23 për qind dhe në fund kanë kërkuar reformë në procedurat e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve në masën 18 për qind.

-Gjyqtarët kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me praktikën e promovimit të gjyqtarëve duke shënuar përmirësimin e tyre në krahasim me ato të mëparshmet. Promovimi i gjyqtarëve përpara përdorimit të sistemit të pikëzimit është konsideruar prje tyre si i padrjetë në masën 67 për qind dhe i drejtë vetëm me 6 për qind.

Pyetje rreth gjyqësorit dhe perceptimi i gjykatësve për institucionet e tjera:

-Numri më i madh i gjyqtarëve hedhin poshtë perceptimin e të tjerëve për gjyqësorin si i korruptuar duke vlerësuar në masën 63 për qind se korrupsioni në drejtësi është vetëm perceptim. Por ndërkaq 35 për qind e të anketuarve thonë se ka korrupsion në drejtësi dhe vetëm 3 për qind e të pyeturve janë kategorikë rreth tij duke theksuar se nuk ka fare korrupsion.

-Rreth raportit që gjyqësori ka me politikën, rreth 69 për qind kanë vlerësuar se ai është i varur pjesërisht nga politika, 22 për qind thonë se është i pavarur prej saj ndërsa vetëm 9 për qind janë të bindur se gjyqësori ka varësi politike.

-Gjyqtarët në 72 për qind të rasteve thonë se nuk kanë pasur ndonjë ofertë pagese në këmbim të favorizimit në një proces gjyqësor ndërsa 28 për qind thonë se kanë pasur oferta të tilla.

-Lidhur me ndërhyrjet në proceset gjyqësore, gjyqtarët kanë seleksionuar në 37 për qind të rasteve ndërhyrjet që vijnë nga individë pa ndonjë kontekst politik apo institucional, në

27 për qind ndërhyrja vjen nga avokatët, në 12 për qind ndërhyrja ka ardhur nga zyrtarë të qeverisë dhe parlamentit dhe nga 10 për qind prej zyrtarëve të pushtetit local. Ndërhyrja nga Presidenca ka ndodhur vetëm në 1.3 për qind të rasteve.

Kushtet e punës:

-Gjyqtarët vijnë të mos jenë të kënaqur me pagën në masën 72 për qind dhe paksa në masën 22 për qind. Vetëm 6 për qind e tyre mendojnë se kanë një pagë të mjaftueshme. Lidhur me sigurinë në punë, sërish numri i gjykatësve që mendojnë se nuk ka siguri është i madh. Rreth 49 për qind nuk ndihen të sigurtë përkundrejt 19 për qind që janë të sigurtë.

Perceptimi për institucionet e tjera:

-Sërish gjyqtarët edhe në vitin 2014 ashtu si në vitin 2012 mendojnë në shumicë se shoqëria civile nuk e ka ndihmuar gjyqësorin. Por ka ndryshuar fort qëndrimi i gjykatësve në raport me median dy vitet e fundit. Për të anketuarit, median përbën presion për ta në masën 62 për qind dhe mbështetje vetëm 9 për qind.

-Gjykatësit kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me korrupsionin për institucionet publike të vendit përfshirë edhe median. Sipas tyre qeveria dhe media janë dy institucionet më të korruptuara, në të njëjtën masë për 35 për qind të të anketuarve, duke vijuar më pas me Parlamentin me 19 për qind. Presidenti dhe prokuroria vijnë në fund respektivisht me 6 për qind dhe 5 për qind.

Rekomandime:

-Gjyqtarët duhet të përfshihen më tepër në debatin për reformën në drejtësi. Disa prej propozimeve të tyre të përfshira në përgjigjet e pyetjes nr 12 të anketimit nuk janë prekur nga debatet e deritanishme për reformën, edhe pse konsiderohen të rëndësishme nga gjyqtarët.

-Duhet përmirësuar dhe lehtësuar procedurat që kryhen prej gjykatësve dhe të cilat nuk përfshihen në procesin gjyqësor nëpërmjet riorganizimit të punës në gjykata, rritjes së cilësisë së personelit ndihmës, rishikimit të roleve në hierarkinë e gjykatave

-Shtyrja e proceseve gjyqësore reduktohet maksimalisht nëpërmjet ndërtimit të një sistemi efikas të thirrjes së dëshmitarëve nëpërmjet postës apo shërbimeve private të lajmërimit, vendosja e një buxheti të ndarë për këtë shërbim nga Zyra e Buxhetit Gjyqësor, vendosja e penaliteteve për mungesat në senacat gjyqësore për dëshmitarët, palët, ekspertët, gjykatësit, prokurorët.

-Duhet rishikuar ligji për avokatinë dhe kodi i procedurave civile dhe ai i procedurave penale në konsultim të gjerë me gjykatësit

-Duhet marrë në konsideratë shkrirja e inspektoriatit të kontrollit në ministrinë e Drejtësisë dhe përmirësimi i rolit të ministrit të Drejtësisë në KLD

-Konferenca gjyqësore të ketë mundësi të korrigojë përbërjen apo punën e KLD-së sa herë e shih të nevojshme nëpërmjet procedurash transparente dhe votimit të lirë dhe transparent të anëtarëve të saj

-Të krijohet statusi i gjyqtarit, të konsiderohet me përparësi rritja e pagave të gjyqtarëve dhe përmirësimi i kushteve të tyre të punës përfshirë edhe sigurinë

-Të konsiderohet për diskutim unifikimi i praktikës gjyqësore, rishikim i kompetencave të Gjykatës së Lartë, kompetencat e inspektorëve të KLD.

-Të përmirësohet më tej sistemi i pikëzimit vecanërisht nëpërmjet rritjes së pikëve që lidhen me performancën në ushtrimin e detyrës së gjykatësit